

Sunny Hill mbyll
edicionin 2026, Prishtina
mirëpriti mijëra vizitorë
nga e gjithë bota



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI NË DETYRË, ALBIN KURTI, KA FTUAR LIDERËT E PARTIVE POLITIKE
NË DISKUTIME PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

DREJT NJË MARRËVESHJE, POR PA GARANCI PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 3



Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë PDK-së, LDK-së dhe Aleancës për takim në Kryeministri, me qëllim, siç ka

thënë ai, "për të biseduar për rrugën përpara". Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se zhvillimet e fundit në LDK, por edhe

pozicionimet e përgjithshme të partive politike, nuk japin sinjale të sigurta dhe premtuese për formimin e institucioneve të reja

**NGA ARRESTIMET
TE GËRMIMET PËR
VARREZA TË
DYSHUARA MASIVE
NË ZUBIN POTOK:
ÇFARË DIHET DERI
MË TANI?**

F. 7



**LIGJI ULI
DALLIMET NË
ÇMIMET E
BARNAVE NË
KOSOVË, POR
ZBATIMI NXORI
SFIDA TË REJA**

F. 3



AKTUALE



**OBJEKTET LOGJISTIKE NË RUSI
SËRISH NË SHËNJESTËR, NDËRSA
ZELENSKY KËRKON PËRSHPEJTIMIN
E DËRGIMIT TË PATRIOTËVE**

F. 2

**KRYEPROKURORI I SHTETIT
VLERËSON ANGAZHIMIN
E INSTITUCIONEVE
NË RASTIN E VARREZAVE
MASIVE NË ZUBIN POTOK**

F. 6

**GRATË KËRKOJNË MË SHUMË
PANAIRE PËR SHITJEN
E PRODUKTEVE**

F. 5

EKONOMI



**NGA 1 SHTATORI APLIKOHET
TARIFA E RIKYÇJES PËR
KONSUMATORËT E SHKYÇUR
PËR MOSPAGESË**

F. 8

**GIZ-i DHE OEGJK-ja NËNSHKRUAJNË
MARRËVESHJE GRANTI
PËR INVESTITIME NË ENERGINË
E RIPËRTËRITSHME**

F. 8

SPORT



**DUKAGJINI NDAN RRUGËT ME
ARSIM THAQIN**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBJEKTET LOGJISTIKE NË RUSI SËRISH NË SHËNJESTËR, NDËRSA ZELENSKY KËRKON PËRSHPEJTIMIN E DËRGIMIT TË PATRIOTËVE

KIEV, 3 GUSHT - Ukraina dhe Rusia shkëmbyen edhe një valë tjetër sulmesh me dronë gjatë natës, duke goditur objekte logjistike, energjetike dhe infrastrukturë civile, ndërsa presidenti Volodymyr Zelensky shprehu pakënaqësinë ndaj aleatëve perëndimorë për vonesat në dërgimin e sistemeve të mbrojtjes ajrore Patriot dhe ndihmës tjetër ushtarake që, sipas tij, nevojitet urgjentisht. Ukraina vazhdoi fushatën e saj për ta goditur Wildberries, shitësin më të madh online në Rusi, këtë herë duke sulmuar një depo në rajonin rus të Vladimirit. Autoritetet rajonale dhe vetë kompania e konfirmuan sulmin. “Si rezultat i sulmit, shpërtheu një zjarr në objektin logjistik të kompanisë në rajonin e Vladimirit. Njerëzit janë evakuuar”, tha kompania më 3 gusht, duke shtuar se nuk pati viktime.

Sulmi ndodhi një ditë pasi dronët goditën një depo të Wildberries në rajonin e Samarës, rreth 800 kilometra larg kufirit me Ukrainën, sipas guvernatorit rajonal dhe videove

të publikuara në internet.

Javët e fundit forcat ukrainase kanë goditur rreth një duzinë deposh të Wildberries në rajone të ndryshme të Rusisë. Ukraina e ka akuzuar Wildberries se mbështet logjistikën ushtarake të Rusisë dhe shet mallra me përdorim të dyfishtë, duke kontribuar kështu në përpjekjet luftarake të Moskës. Moska i ka mohuar këto akuza.

Në atë që duket të ketë qenë një sulm hakmarrës nga forcat ruse, një depo që i përket shitësit online ukrainas Rozetka në rajonin e Kievit u godit nga dy dronë më 2 gusht. Nuk u raportuan të lënduar.

Sulmi pasoi një goditje ndaj të njëjtit objekt një ditë më parë, ku mbeti i vrarë një person dhe u plagosën të paktën gjashtë të tjerë, sipas prokurorisë rajonale të Kievit.

Kanalet monitoruese në Telegram raportuan shpërthime në mbarë Gadishullin e Krimesë më 3 gusht, duke cituar banorë vendas, të cilët raportuan gjithashtu për një zjarr pranë portit të Kerçit, ndërsa qarkullimi në Urën e Krimesë u pezullua



përkohësisht.

Tre persona u vranë dhe dy të tjerë u plagosën në një sulm gjatë natës në Krime, sipas Sergei Aksyonov, kreut të vendosur nga Rusia në gadishullin që Moska e aneksoi në mënyrë të paligjshme nga Ukraina në vitin 2014.

Ministria ruse e Mbrojtjes tha më 3 gusht se mbrojtja ajrore e saj kishte kapur dhe rrëzuar 131 dronë ukrainas gjatë natës në disa rajone të vendit.

Sipas komandantit të njërive të dronëve të Ukrainës, Robert Brovdi, njësitë e tij goditën katër rafineri ruse të naftës dhe terminalin detar të Tamanit gjatë

katër ditëve, duke shkaktuar dëme të mëdha, përfshirë shkatërrimin e raportuar të 12 rezervuarëve të karburantit.

Ndërkohë, forcat ruse vazhduan sulmet ndaj Ukrainës, duke lëshuar 181 dronë sulmues gjatë natës, sipas Forcave Ajrore të Ukrainës.

Vetëm gjatë javës së kaluar, Rusia lëshoi rreth 1.900 dronë, afro 1.600 bomba ajrore dhe 144 raketa të llojeve të ndryshme, përfshirë raketa balistike, kundër Ukrainës, tha Zelensky në një postim në rrjetet sociale më 2 gusht.

Pasi ka bërë pak ose aspak

përparim territorial përgjatë vijës së frontit prej më shumë se 1.200 kilometrash këtë vit, Moska ka intensifikuar sulmet me raketa ndaj Ukrainës, në një kohë kur vendi po përballet me mungesa të mëdha të sistemeve të mbrojtjes ajrore të afta për të interceptuar raketat balistike me shpejtësi të lartë.

Pas sulmeve të fundit vdekjeprurëse ruse ndaj Kievit dhe qyteteve të tjera ukrainase, Zelensky shprehu pakënaqësinë ndaj aleatëve të tij perëndimorë, duke bërë thirrje për përsheptimin e dërgimit të raketave Patriot dhe armëve të tjera që nevojiten urgjentisht. “Bota ka raketa Patriot. Ajo që ka rëndësi tani është që partnerët tanë të marrin vendimin politik - vendimin për të siguruar furnizimet e nevojshme”, tha Zelensky në fjalimin e tij të mbrëmjes më 1 gusht. “Shtetet e Bashkuara e dinë se çfarë na duhet. Evropa e di se çfarë na duhet... Raketat për t’u mbrojtur nga raketat balistike duhet t’i mbrojnë njerëzit dhe jo të qëndrojnë në depo”, shtoi ai.

TRUMPI THOTË SE BISEDIMET ME IRANIN RIFILLOJNË MË 3 GUSHT, PASI ANULOI ‘SULMIN MË TË MADH QË NGA LUFTA E DYTË BOTËRORE’

UASHINGTON, 3 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, tha se anuloi “sulmin më të madh që nga Lufta e Dytë Botërore” kundër Iranit, pas një kërkesë nga Teherani dhe kërkesave të aleatëve të SHBA-së në Gjirin Persik, duke shtuar se bisedimet e paqes do të rifillojnë më 3 gusht, ndërsa një marrëveshje për Ngushticën strategjike të Hormuzit është “e afërt”. “Tani ajo që po bëjmë është se po flasim me ta në formën e negociatave. Ato fillojnë nesër [3 gusht] pasdite”, u tha ai gazetarëve në bordin e Air Force One më 2 gusht.

Trumpi nuk dha detaje për pjesëmarrësit apo vendin ku do të zhvillohen negociatat e reja. Katari dhe Pakistani kanë vepruar si ndërmjetës në bisedimet mes Uashingtonit dhe Teheranit. Më 30 korrik, Ministria e Jashtme e Katarit tha se nuk ishte planifikuar asnjë takim i nivelit të lartë në Doha në ditët në vijim, pas deklaratave të mëhershme të Trumpit. “Do të doja shumë [të arrinim një marrëveshje]”, tha Trump. “Kjo do të shpëtonte shumë jetë... Ne kishim planifikuar një sulm që do të kishte qenë sulmi më i madh që nga Lufta e Dytë Botërore dhe do



të kishte qenë katastrofik për ta. Ata nuk donin që ne ta bënim”.

Ai tha se Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Katari, së bashku me Iranin, i kërkuar të anulonte sulmet ajrore të planifikuara ndaj Iranit. Trump tha se Teherani kërkoi “me shumë këmbëngulje” që të mos ndërmerreshin sulmet. “Ata thanë se duam të arrijmë një marrëveshje”, shtoi ai.

“Ishim gati të vepronim, afërsisht në këtë kohë, dhe do të kishte qenë një sulm masiv”.

“Por kur aleatët kërkuar ta anulonim... dhe arsyeja pse e bënë këtë është sepse ata mendojnë se ka një marrëveshje. Ka një marrëveshje për Hormuzin dhe do të ketë një marrëveshje për... çarmatimin bërthamor të

Iranit.” “Një marrëveshje është e afërt sa i përket Ngushticës së Hormuzit dhe, në fund, edhe çarmatimit bërthamor të Iranit”, tha ai.

Këto deklarata pasuan komentet që ai bëri një ditë më parë, kur tha se kishte vendosur të “pezullonte” sulmet e reja, sepse “parametrat” e një marrëveshjeje ishin dakordësuar me Teheranin dhe se Izraeli po i bashkohej këtij angazhimi. “SHBA-ja është e gatshme dhe e përgatitur të veprojë kundër Republikës Islamike të Iranit me një nivel terrori ushtarak, force dhe fuqie që nuk është parë që nga Lufta e Dytë Botërore. Pavarësisht kësaj, Irani dhe vende të tjera të Lindjes së Mesme sapo na kanë kërkuar të mos ndërmarrim asnjë sulm,

pasi parametrat e një marrëveshjeje janë dakordësuar”, shkroi Trump në Truth Social në mbrëmjen e 1 gushtit. “Kjo do të përfshinte hapjen e menjëhershme, të plotë dhe të pakushtëzuar të ngushticës së Hormuzit, si dhe fundin e kërcënimit bërthamor të Iranit”.

“Bazuar në këtë kërkesë, kam rënë dakord, për të mirën e ardhshme të BOTËS dhe, po ashtu, për mbijetesën e një Irani të suksesshëm dhe të begatë, ta anuloj sulmin, me kusht që të arrihet shpejt një marrëveshje”, shkroi ai.

Trump ka kërcënuar shpesh me sulme të mëdha ndaj Iranit, për t’i anuluar më pas, duke pretenduar se një marrëveshje mes Uashingtonit dhe Teheranit ishte e afërt. Deri më tani, një marrëveshje e qëndrueshme paqeje ka mbetur e paarritshme, ndërsa sulmet hakmarrëse nga të dyja palët kanë rifilluar.

Megjithatë, sipas mediave iraniane, burime ushtarake në Iran mohuan pretendimin e Trumpit se Teherani i kishte kërkuar Uashingtonit të përmbahej nga nisja e sulmeve të reja.

Agjencia iraniane Mehr News më 2 gusht citoi burime të pidentifikuara, sipas të cilave

deklarata e Trumpit ishte “thjesht një tjetër gënjeshtëri” dhe një përpjekje për të “shantazhuar sundimtarët e Gjirit Persik dhe për t’i vënë nën presion me kërcënime”.

Teherani nuk komentoi menjëherë deklaratat e fundit lidhur me rifillimin e bisedimeve më 3 gusht.

Megjithëse Trump fillimisht tha se eliminimi i kërcënimit bërthamor të Teheranit ishte objektivi kryesor i luftës SHBA-Izrael kundër Iranit, e cila filloi më 28 shkurt, javët e fundit ai është përqendruar te liria e qarkullimit në Ngushticën e rëndësishme të Hormuzit.

Më shumë se 20 për qind e furnizimit botëror me naftë dhe gaz kalonte përmes ngushticës para luftës, por Irani, herë pas here, e ka bllokuar në mënyrë efektive këtë rrugë ujore, përfshirë edhe përmes sulmeve ndaj anijeve, për të cilat tha se nuk kishin marrë miratimin e duhur nga Teherani. Irani ka kërcënuar gjithashtu se do të vendosë tarifa ose pagesa për anijet që kalojnë nëpër ngushticë.

Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera kanë këmbëngulur se ngushtica është një rrugë ujore ndërkombëtare dhe nuk është nën kontrollin e asnjë shteti.

LIGJI ULI DALLIMET NË ÇMIMET E BARNAVE NË KOSOVË, POR ZBATIMI NXORI SFIDA TË REJA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 GUSHT - Demokraci Plus (D+) ka publikuar analizën "Transparenca dhe zbatimi i rregullimit të çmimeve të produkteve medicinale në Kosovë", e cila vlerëson ndikimin e reformës për nivelizimin e çmimeve të barnave në barnatoret e Kosovës dhe sfidat e shfaqura gjatë zbatimit të saj. Sipas analizës, miratimi i Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale ishte një reformë e nevojshme, pasi për më shumë se dy dekada qytetarët paguanin çmime të ndryshme për të njëjtin produkt medicinal në barnatore të ndryshme. Po ashtu, në disa raste institucionet publike kishin blerë barna me çmime dukshëm më të larta sesa ato në treg. Megjithatë, D+ vlerëson se zbatimi i reformës është shoqëruar me vonesa për shkak të kapaciteteve të kufizuara institucionale. Edhe pse ligji hyri në fuqi në vitin 2023, Lista e parë Zyrtare e Çmimeve filloi të zbatohet vetëm në shkurt të vitit 2025. Periudha e tranzicionit solli disa probleme praktike, përfshirë mungesën e çmimeve të deklaruar për disa produkte, paqartësitë në trajtimin e stoqeve ekzistuese dhe mungesat e përkohshme të disa

barnave, ndër to edhe tretësirat infuzive NaCl. Gjetjet e analizës bazohen edhe në një anketë me qytetarë, ku rezultoi se rreth 81 për qind e të anketuarve vazhdojnë të perceptojnë dallime në çmimet e barnave. Ndërkohë, 40 për qind e qytetarëve nuk janë në dijeni se çmimi zyrtar i produktit medicinal është i shënuar në banderolë. Vetëm 5 për qind e qytetarëve kanë deklaruar se kanë raportuar ndonjëherë raste të dyshuara për mospërputhje të çmimeve, situatë që, sipas D+, lidhet edhe me mungesën e një fushate të mjaftueshme informuese për publikun. Analiza evidenton edhe mangësi në modelin aktual të rregullimit të çmimeve. D+ argumenton se ligji nuk parasheh mundësi për negociim të drejtpërdrejtë të çmimeve me kompanitë farmaceutike në raste të jashtëzakonshme, siç ishte sigurimi i vaksinave gjatë pandemisë Covid-19. Po ashtu, organizata ngre shqetësime për marzhën maksimale prej 7.5-përqindësh për qarkullimin me shumicë dhe mungesën e një përkufizimi të qartë për "shpenzimet e tjera" të cilat mund të ndikojnë në interesimin e operatorëve ekonomikë për furnizimin e tregut me produkte të caktuara.



Sipas analizës, gjatë vitit 2026 janë tërhequr autorizimet e marketingut për 33 produkte origjinatore, duke ngritur shqetësime për ndikimin e modelit aktual në sigurinë e furnizimit me barna. D+ ka trajtuar edhe çështjen e kontrabandës së barnave, duke theksuar se nivelizimi i çmimeve nuk e ka eliminuar këtë dukuri. Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se në vitin 2025 janë konfiskuar 1 823.30 kilogramë

produkte medicinale me vlerë mbi 93 mijë euro. Sipas organizatës, këto të dhëna tregojnë se luftimi i kontrabandës kërkon masa më të gjera sesa vetëm rregullimin e çmimeve. Në përfundim të analizës, D+ rekomandon rishikimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale, duke kërkuar qartësimin e kompetencave institucionale për mbikëqyrje, rishikimin e marzhës prej 7.5-përqindësh, definimin e

"shpenzimeve të tjera", krijimin e bazës ligjore për negociimin e çmimeve në raste të jashtëzakonshme dhe riorganizimin e kompetencave ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe mekanizmave teknikë të sistemit. Sipas D+, këto ndryshime do të ndihmonin në rritjen e fleksibilitetit, parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së reformës së çmimeve të barnave në Kosovë.

KDI-ja MIRËPRET VENDIMIN E SUPREMES PËR SHFUQIZIMIN E DISPOZITAVE TË RREGULLORES PËR VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 GUSHT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mirëpritur vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara të Rregullores Zgjedhore nr. 04/2026 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Sipas Gjykatës, këto dispozita tejkalonin Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke vendosur kushte dhe kufizime të reja për akreditimin dhe veprimtarinë e vëzhguesve. Sipas KDI-së, dispozitat e shfuqizuara i jepnin KQZ-së kompetencë për të kërkuar informacione mbi burimet e financimit të organizatave pa bazë të qartë ligjore, zgjeronin kërkesat për dokumentacion ndaj organizatave vëzhguese dhe krijonin kritere të paqarta për refuzimin e akreditimit të organizatave dhe mediave. "Këto rregulla linin hapësirë për vendimmarrje arbitrare dhe mund të kufizonin pjesëmarrjen e akterëve të pavarur në



monitorimin e zgjedhjeve. Rregullorja po ashtu kufizonte pjesëmarrjen e vëzhguesve që ishin në procedurë hetimore për shkelje zgjedhore, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Ky kufizim në anën tjetër nuk vlente edhe për komisionerët që mund të ishin

në procedura hetimore. Për më tepër, rregullorja kufizonte qasjen e akterëve në mbledhjet publike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, ndonëse karakteri publik i këtyre mbledhjeve garantohet me ligj, është thënë në komunikatën e

KDI-së. KDI-ja kishte vlerësuar se këto dispozita jo vetëm që tejkalonin ligjin, por edhe rrezikonin ta dobësonin rolin e organizatave të shoqërisë civile dhe medieve në monitorimin e proceseve zgjedhore. "Një kufizim i tillë do të cenonte transparencën,

llogaridhënien dhe besimin e qytetarëve në integritetin e zgjedhjeve. Vendimi i Gjykatës Supreme konfirmon se të drejtat dhe detyrimet e subjekteve nuk mund të kufizohen apo zgjerohen përmes akteve nënligjore pa mbështetje të qartë në ligj. Ky aktgjykim vendos një standard të rëndësishëm për administrimin e proceseve zgjedhore dhe për respektimin e parimeve të ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe transparencës", theksohet në komunikatën e KDI-së. KDI-ja i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ta zbatojë pa vonesë aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ta harmonizojë Rregulloren për Vëzhguesit e Zgjedhjeve me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. "Ky proces duhet të zhvillohet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, me konsultim publik të organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe akterëve të tjerë relevantë", thuhet në komunikatën e KDI-së.



KRYEMINISTRI NË DETYRË, ALBIN KURTI, KA FTUAR LIDERËT E PARTIVE POLITIKE NË DISKUTIME PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

DREJT NJË MARRËVESHJE, POR PA GARANCI PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë PDK-së, LDK-së dhe Aleancës për takim në Kryeministri, me qëllim, siç ka thënë ai, “për të biseduar për rrugën përpara”. Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se zhvillimet e fundit në LDK, por edhe pozicionimet e përgjithshme të partive politike, nuk japin sinjale të sigurta dhe premtuese për formimin e institucioneve të reja

PRISHTINË, 3 GUSHT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thotë se do të bashkëpunojë me fituesen e zgjedhjeve të 7 qershorit, Lëvizjen Vetëvendosje (LV), për një marrëveshje që do të çonte drejt formimit të institucioneve të reja. Por, vëzhguesit mbeten skeptikë se një marrëveshje e tillë do të ofronte zgjidhje, duke përmendur përçarjet brenda partisë që udhëhiqet nga Lumir Abdixhiku. Nënkrjetari i LDK-së, Lufti Haziri, thotë për Radion Evropa e Lirë se gjatë kuvendit partiak të mbajtur më 30 korrik është arritur pajtimi që ky subjekt të bashkëpunojë me partinë e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, për formimin e institucioneve. “Në parim ne

jemi pajtuar. Është konfirmuar edhe nga Kuvendi që LDK-ja do të marrë pjesë në procesin e bashkëpunimit për ndërtimin e institucioneve, duke dhënë kontribut në përballimin dhe largimin e një mundësie për zgjedhje të tjera në Kosovë”, thekson Haziri për Radion Evropa e Lirë. Bisedimet e LDK-së me LV-në për një marrëveshje të mundshme u pezulluan më 15 korrik për shkak të kërkesës së një pjese të zyrtarëve të LDK-së për shkarkimin e kryetarit Lumir Abdixhiku pas pakënaqësive për rezultatin zgjedhor. Abdixhiku i mbijetoi mocionit për shkarkim, por dallimet dhe mospajtimet brenda LDK-së, të cilat janë shpërfaqur përmes

votimit për dhe kundër tij, mbeten të qarta, vlerësojnë zyrtarë të lartë të LDK-së, por edhe njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Krijimi i unitetit në LDK rreth një vendimi të përbashkët të 18 deputetëve të saj lidhur me një marrëveshje eventuale me LV-në mbetet sfida. Në mesin e tyre ka edhe persona që votuan për largimin e Abdixhikut nga kreu i partisë. Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, pas takimit me përfaqësuesit e partive politike parlamentare, të premtën, në një konferencë për medie, e cilësoi lajm të mirë paralajmërimin e Abdixhikut për heqjen e pezullimit për bisedimet për krijimin e

institucioneve. Ajo tha se është shumë e rëndësishme që këto takime të vazhdojnë në mënyrë që të përmbyllet konstituimi i institucioneve të dala nga zgjedhjet e 7 qershorit. “Pra, ato [takimet] të thirren dhe të mbahen dhe të ketë përpjekje maksimale, seriozitet, që të arrihet një marrëveshje, me të cilën arrijmë, pra të kemi një konsensus për zgjedhjen e presidentit apo presidentes së vendit. Pra është shumë e rëndësishme që këto takime të vazhdojnë sa më parë”, tha Haxhiu. Por, një marrëveshje e mundshme ndërmjet LV-së dhe LDK-së, ende nuk duket në horizont, ndonëse kanë mbetur më pak se një javë deri në seancën konstituive të Kosovës, të caktuar më 6 gusht. Me konstituimin e Kuvendit nis rrjedhja e afateve për formimin e Qeverisë së re të Kosovës, por edhe zgjedhjen e presidentit. Për këtë të fundit deputetët e legjislaturës së re do të kenë

kohë 60 ditë nga data e konstituimit të Kuvendit që ta votojnë kreun e ri të shtetit.

Haziri: Për 24 orë LDK-ja i mbyllë të gjitha çështjet parimore

Kuvendi i LDK-së, ku delegatët i dhanë besimin Abdixhikut që të vazhdojë në krye të partisë, shpërfaqti qartë dallimet përbrenda kësaj partie. Për vazhdimin e mandatit të kryetarit Lumir Abdixhiku votuan 170 delegatë, 152 ishin kundër dhe 5 abstenuan. Haziri thekson se me gjithë dallimet e dukshme përbrenda LDK-së, ajo tash gjendet përballë ofertës nga partia e parë fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, për bashkëpunim. Parimet, të cilat LDK i ka shprehur si parakushte për një marrëveshje të mundshme me LV-në janë: marrëveshje për të gjitha (institucionet; Kuvend, Qeveri, Presidencë) ose asnjë; agjenda shtetërore, politika

GRATË KËRKOJNË MË SHUMË PANAIRE PËR SHITJEN E PRODUKTEVE

PRISHTINË, 3 GUSHT - Punime dore, veshje kombëtare dhe produkte të tjera artizanale u ekspozuan në panairin “Gratë në Biznes”, i cili nisi të hënën, më 3 gusht, në Prishtinë dhe do të zgjasë deri më 5 gusht. Gratë pjesëmarrëse në panair kërkuar që aktivitete të tilla të organizohen më shpesh pasi, sipas tyre, panairët u krijojnë mundësi për t'i ekspozuar dhe shitur produktet e tyre. Panairi u organizua nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit e Kosovës (MINTI). Shpresa Makasqi kishte ekspozuar në panair çanta dhe aksesori të ndryshëm. Ajo merret me këtë biznes prej 15 vjetësh dhe tha se panairët janë ndër mundësitë e vetme për t'i shitur produktet e saj. “Nuk kemi ku t'i shesim produktet vetëm nëpër panaiare. Këto aktivitete janë të nevojshme sepse puna jonë varet nga panairët. Duhet të organizohen sa më shpesh, ose të ndahen shtëpiza nëpër qytete të ndryshme”, tha Makasqi për Radion Evropë e Lirë. Qeveria në detyrë e Kosovës thotë se gjatë mandatit të kaluar ka punuar për fuqizimin ekonomik të grave. Numri i të punësuarve është rritur nga rreth 303 mijë në



vitin 2019 në 410 mijë, ndërsa në tregun e punës janë përfshirë edhe rreth 53 mijë gra dhe vajza të reja. Leonida Jakaj (djathtas), studente në Fakultetin e Dizajnit Grafik në Ferizaj, për herë të parë mori pjesë në panair, ku ekspozoi produktet e saj. Ajo tha se

pjesëmarrja në panair i krijon mundësi të gjejë klientë të rinj dhe t'i promovojë produktet e saj. Përveç veshmbathjeve të ndryshme, në panair u ekspozuan edhe produkte ushqimore sikurse mjalti. Nga mbi 265 mijë biznese të regjistruara në Kosovë, rreth 48

500 udhëhiqen nga gratë, që përbën mbi 18 të bizneseve. Vetëm gjatë këtij viti në Kosovë janë regjistruar mbi 2 200 biznese me pronare gra. Numri më i madh i grave të punësuar në Kosovë është në sektorin e tregtisë, aktivitetet e shërbimeve, gastronomi si dhe

në industrinë përpunuese dhe prodhuese. Mimoza Kusari -Lila, ministre në detyrë e MINTI-t, premtoi se qeveria do të angazhohet për rritjen e mëtejshme të numrit të grave në biznes dhe për krijimin e mundësive për promovimin e produkteve të tyre.

sektoriale, programet qeverisëse, interesi i vendit si dhe ndarja e përgjegjësi. “Këto tri parime neve na bashkojnë si grup parlamentar. Kuvendi [i LDK-së] ka kërkuar që kjo e drejtë të ushtrohet deri në fund. Se si do të përmbyllet kjo kërkesë, tani është çështje e negociatave [me LV-në]”, thekson Haziri. Ai shton se që nga bisedimet e para formale, të zhvilluara mes Kurtit, Abdixhikut dhe ish-presidentes Vjosa Osmani më 10 korrik, LV-ja është njoftuar për parimet mbi të cilat LDK-ja e sheh një marrëveshje të mundshme. Sipas tij, tani i takon LV-së, që në bisedimet e ardhshme të tregojë nëse i respekton dhe pajtohet me këto parime. Haziri thotë se në rast se arrihet pajtimi, uniteti i grupit parlamentar të LDK-së mund të sigurohet përmes bashkëpunimit të brendshëm. “Këto nuk janë çështje të thjeshta, por nëse ka vullnet politik dhe ka gatishmëri [nga LV-ja], atëherë LDK-ja i përmbyll për 24 orë të gjitha çështjet parimore. Neve [në LDK] nuk na ndan asgjë, ndërkaq ndarja e përgjegjësi është krejt e fundit”, thekson Haziri. Ai shprehu besimin në pjekurinë politike të grupit parlamentar të LDK-së për një unitet rreth vendimeve të kreut të partisë. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë

se ka “vullnet dhe gatishmëri” mes partisë së tij Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike për arritjen e një marrëveshjeje për formimin e institucioneve të reja të vendit gjatë javës së ardhshme. I pyetur të shtunën vonë se kur do t'i rinisin takimet me Abdixhikun teksa po afron seanca konstituive e Kuvendit e 6 gushtit, Kurti tha: “Do të përpiqemi që t'i shfrytëzojmë këto ditë, në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur kur fillon seanca për konstituimin e institucioneve të legjislaturës së 11-të”. “Mirëpo nuk mund ta parashikojmë ende rezultatin, nuk do të mungojnë përpjekjet. Ekziston edhe interesimi, edhe vullneti, edhe gatishmëria, por në javën e ardhshme marrim vesh gjithçka”, tha Kurti për Ekonomia Online pas një ngjarjeje të partisë së tij në Prishtinë për mikpritjen e mërgimtarëve.

Mundësitë për një marrëveshje dhe skepticizmi për numrat

Njohësit e zhvillimeve politike thonë se zhvillimet e fundit në LDK, por edhe pozicionimi i partive politike në përgjithësi, nuk japin sinjale premtuese dhe të sigurta për formimin e institucioneve të reja. Sipas tyre, rezultati i ngushtë i votimit për dhe kundër vazhdimit të mandatit të Abdixhikut për kryetar rikonfirmon se brenda

LDK-së ekzistojnë çarje të thella ndërmjet dy taborëve. Çarjet e tilla, vlerësojnë ata, e vështirësojnë ose e pamundësojnë fare funksionimin normal të kësaj partie dhe secilën strategji që mund ta planifikojë Abdixhiku për negociatat me Lëvizjen Vetëvendosje, për një marrëveshje të mundshme për formimin e institucioneve të reja të vendit. Analisti Rrahman Paçarizi, profesor i gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropë e Lirë se deklarata e Hazirit, se LDK-ja do të shkojë drejt një marrëveshjeje me LV-në në rast se ajo ia respekton parimet e deklaruara, nuk e qartëson situatën. “Më shumë është në funksion të ndërtimit të rrëfimit se LDK-ja nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet si bllokuese e formimit të institucioneve”, thotë Paçarizi. Ai shton se ky veprim i LDK-së del si i kushtëzuar për shkak se partitë politike në vend, përfshirë edhe LV-në, ende ushqejnë ndërtimin e rrëfimeve për fajtorët e mosformimit të institucioneve. Paçarizi shpreh mendimin se as LDK-ja dhe as partitë e tjera nuk do të deklarohen kundër ndërtimit të institucioneve. Por, ai sheh pak gjasa që të gjendet një formulë nga kryetari i LDK-së, por edhe nga tabori i pakënaqur me të brenda kësaj partie, për të krijuar qëndrim të përbashkët të 18 deputetëve ndaj një marrëveshjeje eventuale me

LV-në. Paçarizi thekson se mundësitë për një marrëveshje ende nuk janë të shteruara tërësisht, por marrëveshja do të varet edhe nga vullneti dhe serioziteti i liderit të LV-së, Albin Kurti, me të cilat do t'i qaset ndërtimit të institucioneve. Megjithatë, Paçarizi shpreh skepticizëm lidhur me formimin e institucioneve edhe në rast se arrihet një marrëveshje ndërmjet LV-së dhe LDK-së. Nyja e gjithë problemit për ndërtimin e institucioneve, sipas tij, mbetet zgjedhja e presidentit të vendit. Në dy raundet e para të votimit për zgjedhjen e presidentit kërkohen votat e 80 deputetëve. Në rast se zgjedhja e presidentit dështon në dy raste atëherë, në raundin e tretë të votimit, kandidati që merr 61 vota në Kuvendin me 120 vende zgjidhet president. Paçarizi thekson se duhet pasur parasysh faktin se LV-ja ka 53 deputetë të cilëve në votim mund t'u bashkëngjiten edhe nëntë ose dhjetë deputetë nga komunitetet joshumicë. “Kur i shtojmë kësaj edhe 18 deputetë të LDK-së, atëherë mund të bëhet një numër prej 80 deputetësh. Por, është tepër e vështirë të sigurohen të 18 votat e LDK-së për një zgjidhje, e cila nuk do të ishte maksimale për këtë parti. Mendoj që as zgjidhjet më optimale nuk mendoj se do të kryejnë punë këtu”, thekson Paçarizi. Analisti Artan Muhaxhiri

gjithashtu thotë se pavarësisht prej rikonfirmimit të mandatit të Abdixhikut në krye të partisë, përplasjet brenda LDK-së tregojnë se çfarëdo marrëveshje me LV-në nuk do ta marrë mbështetjen e të gjithë 18 deputetëve të kësaj partie në Kuvend. “Minimumi i ka gjashtë ose shtatë deputetë më pak se sa numri i përgjithshëm i deputetëve. Kështu që Abdixhiku e ka vetëm një detyrë, ta ndryshojë për 180 shikime qasjen ndaj deputetëve të pakënaqur dhe personaliteteve shumë të rëndësishme të LDK-së, të cilët e kundërshtojnë mënyrën e lidershipit të tij”, thekson Muhaxhiri. Ai shton se, megjithatë, nuk pret që qasja e Abdixhikut të ndryshojë dhe ai të jetë më fleksibil ndaj kundërshtarëve të tij brenda partisë. “Prandaj, marrë parasysh edhe një numër faktesh të tjera, duket që opioni i vetëm do të jenë zgjedhjet e reja. Me këtë klimë politike është krejtësisht e pamundur të arrihet numri i 80 deputetëve, që është çelësi i zgjidhjes së problemeve dhe parandalimit të një procesi të ri zgjedhor”, përfundon Muhaxhiri. Në rast se partitë nuk arrijnë ujdj për çështjen e presidentit, atëherë vendi do të shkonte sërish në zgjedhje. Ato do të ishin votimet e dyta që do të mbaheshin për shkak të moskonsensusit për zgjedhjen e kreut të ri të shtetit dhe të katërtat që nga shkurti i vitit 2025.

Kurti pret në takim Ziadin Selën, flasin për zhvillimet në Kosovë dhe Maqedoni

PRISHTINË, 3 GUSHT - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, priti në takim kryetarin e partisë Lidhja Shqiptare dhe deputetin në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, Ziadin Sela.

Duke i uruar mirëseardhje në Prishtinë, kryeministri Kurti e falënderoi kryetarin Sela për vizitën.

Në takim u diskutua lidhur me zhvillimet dhe aktualitetet në Kosovë, me theks përgatitjet për

procesin e konstituimit të legjislaturës së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Republikës, formimin e qeverisë së re dhe zgjedhjen e presidentit ose presidentes.

Po ashtu, krahas zhvillimeve

dhe aktualiteteve në Maqedoninë e Veriut, temë e takimit ishin projektet e rëndësishme infrastrukturore ndërmjet dy shteteve, si rruga Prizren - Tetovë dhe ajo Bllacë - Shkup.



SUNNY HILL MBYLL EDICIONIN 2026, PRISHTINA MIRËPRITI MIJËRA VIZITORË NGA E GJITHË BOTA

PRISHTINË, 3 GUSHT - Është mbyllur me sukses edicioni i sivjetmë i Sunny Hill Festival në Prishtinë, duke sjellë për tri ditë me radhë performanca të artistëve vendorë dhe ndërkombëtarë para mijëra pjesëmarrësve.

Organizatorët bënë me dije se dita e dytë në Satellite Stage ishte e mbushur me muzikë të shkëlqyer nga fillimi deri në fund, duke krijuar një atmosferë festive dhe energjike për publikun.

Me përfundimin e festivalit, Sunny Hill edhe këtë vit konfirmoi statusin e tij si një nga ngjarjet më të mëdha muzikore në rajon, duke e kthyer Prishtinën në qendër të muzikës dhe argëtimit gjatë fundjavës.

Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë se Dua Lipa e ka bërë

Kosovën pjesë të rrëfimit të saj publik kudo ku ka qenë e pranishme. Sipas saj, Sunny Hill lindi nga kjo lidhje dhe nga dëshira e saj për të sjellë në Prishtinë artistë me të cilët ndan skenat më të mëdha të botës.

“Për artistët e rinj shqiptarë, festivali është një nga rastet e rralla për të dalë para një publiku kaq të madh dhe të larmishëm. Ndërkohë, mijëra njerëz nga vende të ndryshme udhëtojnë drejt Prishtinës pikërisht për Sunny Hill-in. Për shumë prej tyre, festivali është edhe takimi i parë i drejtpërdrejtë me Kosovën, me qytetin dhe me njerëzit e saj. Pak ngjarje kulturore i kanë dhënë Kosovës kaq shumë jehonë jashtë vendit dhe e kanë afruar me një publik të gjerë ndërkombëtar”, ka thënë Haxhiu. Ajo e ka uruar Dua Lipën dhe

gjithë ekipin e Sunny Hill-it për këtë edicion si dhe ka falënderuar artistët, publikun dhe secilin që punoi në skenë e prapa saj për t'i bërë të mundur këto tri net në Prishtinë.

Edhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar pas përfundimit të Sunny Hill Festival, duke vlerësuar ndikimin që festivali ka në promovimin e kryeqytetit.

“Prishtina mirëpriti botën. Bota e zbulon Prishtinën. Kjo është fuqia e Sunny Hill”, ka shkruar Rama në një postim në rrjetet sociale. Sipas tij, Sunny Hill Festival vazhdon ta promovojë Prishtinën në arenën ndërkombëtare, duke e bërë kryeqytetin destinacion të mijëra vizitorëve dhe adhuruesve të muzikës nga vende të ndryshme të botës.



INVESTITORË NGA TURQIA INTERESOHEN PËR PARKUN INDUSTRIAL NË FRASHËR TË MITROVICËS



PRISHTINË, 3 GUSHT - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari, ka bërë me dije se në Kosovë po qëndrojnë përfaqësues të kompanisë turke Desird Design R&D, me të cilët ka zhvilluar një takim për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik dhe realizimit të investimeve në vend. Sipas Kusarit, në takim

morën pjesë Engin Öztürk, Hüseyin Emre Kazan, Ömer Güven dhe Yücel Gümrükçü si dhe zëvendëskryeministri Fikrim Damka.

Ajo bëri me dije se Desird Design R&D është një kompani e specializuar në kërkim dhe zhvillim (R&D), prodhimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve mekatronike, e cila eksporton produktet e saj në

më shumë se 60 vende të botës dhe aplikon ekonominë qarkore përmes ripërdorimit të elementeve të metalit dhe qelqit për industrinë e ndërtimit.

Gjatë takimit është diskutuar edhe mundësia e realizimit të një investimi në Zonën Industriale në Frashër të Mitrovicës, ku është duke u ndërtuar parku industrial. Sipas

ministres, ky projekt në fazën fillestare pritet të krijojë dhjetëra vende të reja pune, me potencial për zgjerim të mëtejshëm.

Kusari theksoi se institucionet mbeten të përkushtuara për zhvillimin e infrastrukturës industriale, fuqizimin e prodhimit vendor dhe rritjen e vlerës së produkteve “Made in Kosova”.

KRYEPROKURORI I SHTETIT VLERËSON ANGAZHIMIN E INSTITUCIONEVE NË RASTIN E VARREZAVE MASIVE NË ZUBIN POTOK



PRISHTINË, 3 GUSHT - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, ka vlerësuar lart punën profesionale, përkushtimin dhe angazhimin e të gjitha institucioneve ligjzbatuese të Republikës së Kosovës, të cilat janë të përfshira në rastin e zbulimit të varrezave masive në komunën e Zubin Potokut, ku

janë gjetur mbetje mortore dhe dyshohet se ka trupa të tjerë të viktimave që i përkasin luftës së fundit në Kosovë. “Zbulimi i këtyre varrezave masive është një përpjekje dhe angazhim shtetëror për zbardhjen e së vërtetës dhe vendosjen e drejtësisë. Mbi të gjitha, ndriçimi i këtyre rasteve përbën një detyrim institucional

dhe ligjor ndaj viktimave dhe familjeve të tyre që prej vitesh presin përgjigje për fatin e më të dashurve të tyre”, është thënë në deklaratën e kryeprokurorit të Shtetit, Zejnulla Gashi.

Kryeprokurori i Shtetit vlerëson praninë e të gjitha institucioneve dhe qytetarëve në vendin e ngjarjes ku janë gjetur mbetjet

mortore. “Kontributi dhe bashkëpunimi i secilit kanë qenë dhe mbetët thelbësor për zbardhjen e këtyre rasteve, si dhe për identifikimin e personave përgjegjës të përfshirë në kryerjen e këtyre krimeve me qellim që ata të përballen me drejtësinë”, thuhet në deklaratën e tij.

Qindra shërbime mjekësore gjatë fundjavës në Emergjencën e QKUK-së, 75 të lënduar në aksidente

PRISHTINË, 3 GUSHT - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se gjatë fundjavës Qendra Emergjente ka ofruar gjithsej 992 shërbime mjekësore, duke trajtuar një numër të madh pacientësh. Sipas të dhënave të QKUK-së,

në Reanimim janë trajtuar 227 pacientë, në Emergjencën Kirurgjike 168, në atë Internistike 286, në Emergjencën Ortopedike 200, ndërsa në Sallën e Vogël janë ofruar shërbime për 94 pacientë.

Sa i përket natyrës së lëndimeve janë trajtuar gjashtë raste të personave të rrahur, pesë raste të intoksikimit dhe 75 persona të lënduar në aksidente komunikacioni. Po ashtu, është raportuar edhe një rast i

personit të lënduar me armë të ftohtë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe 85 pranime për trajtim të mëtejshëm në klinikat përkatëse. Sipas QKUK-së, gjatë fundjavës nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes.



NGA ARRESTIMET TE GËRMIMET PËR VARREZA TË DYSHUARA MASIVE NË ZUBIN POTOK: ÇFARË DIHET DERI MË TANI?

Një hetim rreth dyvjeçar i autoriteteve të Kosovës çoi fillimisht në arrestimin e dy personave të dyshuar për krime lufte dhe më pas në gërmime në një lokacion në Zubin Potok, ku dyshohej se ndodhej një varrezë masive. Brenda pak ditësh u zbuluan mbetje mortore me origjinë njerëzore, u arrestua edhe një i dyshuar tjetër për krime lufte, u identifikua një lokacion i dytë ku dyshohet se mund të ketë mbetje mortore, ndërsa në Serbi u arrestua një shtetas i Kosovës nën dyshimin për spiunazh

PRISHTINE, 3 GUSHT - Në Kalludër të Vogël, fshat malor i komunës veriore të Zubin Potokut, në Kosovë, më 28 korrik nisën gërmime nën dyshimet për një varrezë masive. Këto gërmime, sipas autoriteteve, filluan pas një hetimi rreth dyvjeçar të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Disa ditë para nisjes së gërmimeve, u arrestuan dy persona të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile. Rasti i tyre, sipas Prokurorisë, lidhet me këto gërmime. Ndonëse nuk janë bërë publike detaje të sakta se për çfarë dyshohen këta dy të arrestuar, për njërin prej tyre Policia tha se ka gjetur prova se ai kishte qenë “i mobilizuar dhe pjesë aktive gjatë periudhës së luftës në ish-armatën jugosllave”.

Dy të dyshuarit, M.J. dhe M.B., momentalisht gjenden në paraburgim.

Më 2 gusht, Policia e Kosovës arrestoi edhe një person tjetër në lidhje me të njëjtin rast.

Prokuroria Speciale tha se arrestimi i J.R. është rezultat i veprimeve të mëtejshme hetimore, por nuk dha hollësi për rolin e tij të dyshuar.

Avokati i të pandehurit M.B., Dejan Vasiq, tha për Radion Evropa e Lirë se klienti i tij dyshohet se ka qenë në mesin e personave që kanë varrosur viktimat e ngjarjeve të përmendura, në kërkesën për caktimin e paraburgimit. “Ai është i bindur se nuk ka asnjë lidhje me këtë ngjarje, pasi nuk ka qenë fare në vendin që përmend prokurori”, tha Vasiq. Millosh Deleviq, avokat i të pandehurit tjetër M.J., nuk dëshoi të tregonte hollësi se për çfarë dyshohet konkretisht klienti i tij, duke thënë vetëm se vepra penale është cilësuar si krim lufte kundër popullsisë civile.

Çfarë dihet për varrezën masive në Kalludër të Vogël?

Teksa gërmimet vazhdonin, autoritetet konfirmuan se mbetjet e gjetura në Kalludër të Vogël janë me origjinë njerëzore. Por, që nga fillimi i gërmimeve, u ngritën dyshime se mbetjet mortore në këtë lokacion - që është ende duke u gërmuar -



mund t'i takojnë një grupi të caktuar të shqiptarëve të zhdukur me forcë nga lufta e fundit.

Ky grup civil, i njohur si “grupi i intelektualëve”, është i zhdukur që nga 19 prilli i vitit 1999. Në mesin e tyre kishte mjekë, profesorë, avokatë dhe profile të tjera.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, më 29 korrik u tha mediave se ekziston dyshimi fillestar se mbetjet mund t'u përkasin këtij grupi. “Ne nuk mund të konfirmojmë se bëhet fjalë për ta, por ky ka qenë dyshimi ynë i menjëhershëm. Sidoqoftë, duhet t'i presim organet tona të na tregojnë se për çfarë bëhet fjalë atje”, tha Kurti.

Procesi i identifikimit tashmë është në duart e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ndërsa autoritetet kanë theksuar se vetëm analizat forenzike dhe të ADN-së do të përcaktojnë identitetin e viktimave. Prokuroria Speciale u bëri thirrje mediave, qytetarëve dhe zyrtarëve të mos spekulojnë për identitetin e mbetjeve. “...Ende gjithçka është herët, dhe

deklarimet në publik mund ta dëmtojnë procesin e hetimit, e natyrisht mund edhe ta devijojnë rezultatit final”, thuhet në reagimin e Prokurorisë.

Gërmime të reja në Zubin Potok?

Më 2 gusht, Prokuroria dhe Policia njoftuan se është identifikuar edhe një lokacion tjetër në fshatin Jabukë të Zubin Potokut, ku dyshohet se mund të ketë mbetje mortore. Institucionet thanë se do t'i kërkojnë Gjykatës Themelore në Prishtinë leje për të kryer gërmime edhe në këtë vend. Një ditë para njoftimit për lokacionin e dytë, kryeministri në detyrë, Kurti, vizitoi vendin e gërmimeve në Kalludër të Vogël. Ai tha se puna në terren mund të zgjasë “shumë javë, ndoshta edhe shumë muaj”, pasi mbetjet mortore janë gjetur të shpërndara përgjatë një përroi. Ai përsëriti, gjithashtu, thirrjen që Serbia të hapë arkivat shtetërore dhe ushtarake, duke thënë se ato mund të ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave

të zhdukur.

Edhe ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, reagoi pas njoftimit për lokacionin e dytë, duke e cilësuar atë “një rikujtim të rëndë të krimeve të kryera gjatë luftës”.

Arrestimi në Serbi

Derisa hetimet për varrezën e dyshuar masive po vazhdonin në Zubin Potok, autoritetet serbe arrestuan një shtetas të Kosovës nën dyshimin për “spiunazh”. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, R.T., nga Istogu, u arrestua më 30 korrik në Kraljevë, ndërsa Gjykata e Lartë në atë qytet i caktoi masën e paraburgimit prej 30 ditësh. Autoritetet serbe nuk dhanë hollësi për veprimet që i atribuohen atij, përveç se dyshohet për veprën penale të spiunazhit. Në Kosovë, megjithatë, disa burime thanë për Radion Evropa e Lirë se arrestimi lidhet me dyshimet se ai kishte dhënë informacione që çuan te lokacioni ku po zhvillohen

gërmimet për mbetje mortore në Zubin Potok.

Ministri në detyrë i Punës, Familjes, Mbrojtjes Sociale dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare i Kosovës, Andin Hoti, e ka vlerësuar arrestimin e personit, për të cilin pretendon se ka ndihmuar në zbulimin e një varreze të dyshuar masive të dyshuar në Kosovë si “tentim-vrasje ndaj së vërtetës”. “Ky nuk është shtet që kërkon drejtësi. Ky është një aparat shtetëror që vazhdon të mbrojë kriminelët, të frikësojë dëshmitarët dhe të pengojë zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Çdo arrestim i tillë dërgon një mesazh të qartë: kush flet për varrezat masive, ndëshkohet”, shkroi Hoti në “Facebook”.

Hoti nuk ka bërë të ditur se në bazë të cilave informacione pretendon se personi është arrestuar për shkak të ndihmës së supozuar në zbulimin e varrezës masive, ndërsa ai nuk ka qenë i qasshëm për një koment shtesë.

Sipas të dhënave zyrtare, 1.579 persona vazhdojnë të figurojnë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-99.

Azem Syla viziton familjen e Jashar Salihut në Batushë për ngushëllime

PRISHTINE, 3 GUSHT - Ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Azem Syla, ka vizituar familjen e heroit

Jashar Salihu në Batushë të Gjakovës, për t'i shprehur ngushëllime për humbjen e djalit të tij, Blerim Batusha, i cili humbi jetën para disa ditësh në një

aksident trafiku në Zvicër.

Gjatë vizitës Azem Syla u shprehur ngushëllime familjarëve, duke ndarë dhimbjen me ta dhe duke vlerësuar kujtimin dhe figurën e

të ndjerit në këto çaste të rënda për familjen.

Blerim Batusha ishte djali i heroit të luftës së UÇK-së, Jashar Salihu.



KEK-u: Njësia A3 është rikthyer në operim, sistemi po funksionon sipas planifikimeve

PRISHTINË, 3 GUSHT - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka reaguar ndaj raportimeve të publikuara në medie, duke sqaruar se aktualisht po operon në përputhje të plotë me Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike (BVEE) 2026, me njësitet A3 dhe A4 të Termocentralit Kosova A, si dhe me njësinë B2 të Termocentralit Kosova B. Sipas KEK-ut, njësia A3 ishte ndalur përkohësisht për shkak të rrjedhjeve të identifikuara në kaldajë me qëllim të realizimit

të sanimeve teknike. Pas përfundimit të punimeve njësia është rikthyer sot në operim dhe po funksionon në gjendje stabile. Ndërkohë, njësia A5 ndodhet në revizion të planifikuar, sipas BVEE 2026, për periudhën 1-10 gusht 2026. Sa i përket njësisë B1, KEK-u thekson se ajo nuk është thjesht “jashtë prodhimit”, por që nga muaji prill i është nënshtruar projektit më të madh të modernizimit në historinë e saj. Projekti

përfshin rehabilitimin e njësisë, ndërtimin e elektrofiltrave të rinj dhe instalimin e sistemit DeNOx, me përfundim të planifikuar në gjysmën e parë të dhjetorit 2026.

KEK-u vlerëson se paraqitja e kësaj njësie vetëm si “jashtë prodhimit”, pa përmendur investimet dhe punimet e planifikuara, krijon një perceptim të gabuar tek opinioni publik.

Në fund, korporata u ka bërë thirrje medie që, para



publikimit të informacioneve për sektorin energjetik, t'u referohen njoftimeve zyrtare dhe dokumenteve publike, duke theksuar se raportimi pa

kontekst mund të krijojë konfuzion dhe t'i dezinformojë qytetarët mbi gjendjen reale të sistemit elektroenergjetik.

GIZ-I DHE OEGJK-JA NËN SHKRUANJË MARRËVESHJE GRANTI PËR INVESTIME NË ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME

PRISHTINË, 3 GUSHT - GIZ Kosova dhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK - KDWW) kanë nënshkruar një marrëveshje granti për forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e mundësive për investime në sektorin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

Sipas komunikatës për media, bashkëpunimi po realizohet në kuadër të projektit IKI “Mbështetje për Partneritetin për Tranzicionin Klimatik dhe Energjetik”, të zbatuar nga GIZ Kosova.

Marrëveshja u nënshkrua në zyrën e GIZ-it në Prishtinë nga Marianne Alker, udhëheqëse e ekipit të projektit IKI - Mbështetje për Partneritetin për Tranzicionin Klimatik dhe Energjetik, dhe Besnik Vasolli, drejtor ekzekutiv i Odës Ekonomike Gjermano-



Kosovare (OEGJK-KDWW). Përmes këtij bashkëpunimi, GIZ dhe OEGJK-KDWW synojnë të lidhin investitorët gjermanë me institucionet kosovare, institucionet financiare dhe zhvilluesit e projekteve të energjisë së ripërtëritshme.

Sipas njoftimit, nisma do të ndihmojë në krijimin e lidhjeve më të fuqishme ndërmjet akterëve të përfshirë në zhvillimin,

financimin dhe zbatimin e investimeve në energjinë e ripërtëritshme në Kosovë.

Aktivitetet e planifikuara përfshijnë një forum investimesh, tryeza të rrumbullakëta me palët e interesit, ngjarje të rrjetëzimit dhe sesione të synuara për lidhjen e bizneseve. Këto aktivitete do t'u ofrojnë palëve të interesit mundësi për shkëmbimin e informatave, identifikimin e fushave të

mundshme të bashkëpunimit dhe zhvillimin e partneriteteve rreth mundësive konkrete për investime në energjinë e ripërtëritshme.

Bashkëpunimi do t'u ofrojë investitorëve dhe zhvilluesve të projekteve edhe informata praktike mbi kërkesat rregullatore, teknike dhe financiare që lidhen me investimet në energjinë e ripërtëritshme në Kosovë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së dukshmërisë së projekteve të gatshme për investim dhe lidhjes së zhvilluesve të tyre me partnerë të mundshëm gjermanë dhe institucione financiare. “Kjo marrëveshje granti përfaqëson një hap të rëndësishëm në përkthimin e Partneritetit Kosovë - Gjermani për Tranzicionin Klimatik dhe Energjetik në bashkëpunim konkret me sek-


torin privat. Duke lidhur institucionet, investitorët, partnerët financiarë dhe zhvilluesit e projekteve, synojmë të ndihmojmë në krijimin e kushteve të nevojshme për investime të realizueshme në energjinë e ripërtëritshme dhe partneritete të qëndrueshme”, ka theksuar Marianne Alker, udhëheqëse e ekipit të projektit të GIZ-it.

Granti kontribuon në përpjekjet më të gjera në kuadër të Partneritetit Kosovë-Gjermani për Tranzicionin Klimatik dhe Energjetik, me synim avancimin e zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme, forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe mbështetjen e tranzicionit të Kosovës drejt një sistemi energjetik më të pastër dhe më të qëndrueshëm.

DHTIK SHPREH SHQETËSIM PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË BIZNESEVE NË ARBK, KËRKON NDËRRHYRJE URGJENTE TË INSTITUCIONEVE

PRISHTINË, 3 GUSHT - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DHTIK) ka shprehur shqetësim lidhur me publikimin në faqen zyrtare të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) të dokumenteve që, sipas saj, përmbajnë të dhëna të ndjeshme të bizneseve dhe pronarëve të tyre. Përmes një reagimi publik, DHTIK bëri me dije se ka pranuar ankesa nga bizneset anëtare lid-

hur me mundësinë e qasjes së plotë në dokumente si statutet dhe marrëveshjet e shoqërive tregtare të cilat përmbajnë edhe të dhëna personale të pronarëve dhe personave të autorizuar. “DHTIK ka pranuar ankesa nga bizneset anëtare lidhur me lejin e qasjes së plotë në dokumentet si statuti dhe marrëveshjet e shoqërisë, duke përfshirë edhe të dhënat personale të



pronarëve dhe personave të autorizuar, të cilat janë të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale”, thuhet në reagim.

Sipas Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, publikimi i dokumenteve të tilla mund ta cenojë konfidencialitetin e marrëdhënieve kontraktuale dhe afariste të bizneseve. “Publikimi i këtyre dokumenteve me këto të dhëna mund të cenojë konfidencialitetin e marrëdhënieve kontraktuale dhe afariste”, thekson

DHTIK.

Në fund, kjo organizatë u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse të ndërmarrin masa të menjëhershme për adresimin e çështjes dhe të sigurojnë llogaridhënie. “Andaj, DHTIK i bën thirrje institucioneve përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve urgjente për të adresuar këto çështje, si dhe të kërkohet përgjegjësi nga personat përgjegjës”, thuhet në reagim.

Nga 1 shtatori aplikohet tarifa e rikycjes për konsumatorët e shkyçur për mospagesë

Prishtinë, 3 gusht - KESCO, në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, informon konsumatorët se ka pranuar njoftim zyrtar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) lidhur me fillimin e zbatimit të tarifës së rikycjes e cila do të hyjë në fuqi më 1 shtator 2026 në përputhje me Rregullën për Shkyçje dhe Rikycje të miratuar

nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Sipas njoftimit të OSSh-së, nga 1 shtatori 2026 do të aplikohet tarifa e rikycjes për konsumatorët që janë shkyçur nga rrjeti për shkak të mospagesës së detyrimeve financiare dhe që kërkojnë rikycjen e furnizimit me energji elektrike.

Kjo tarifë do të aplikohet krahas tarifës së shkyçjes, e cila tashmë është në fuqi, në përputhje me rregullativën e ZRRE-së.

Me qëllim të informimit në kohë të konsumatorëve, KESCO do ta publikojë këtë njoftim përmes kanaleve të saj zyrtare të komunikimit dhe do ta përfshijë atë edhe në faturat mujore që do të shpërndahen

gjatë muajit gusht.

KESCO u bënë thirrje të gjithë konsumatorëve që faturat e energjisë elektrike t'i paguajnë brenda afateve të përcaktuara në faturë në mënyrë që t'i shmangin procedurat e shkyçjes dhe kostot shtesë që lidhen me shkyçjen dhe rikycjen e furnizimit me energji elektrike.



KOLAPSI NGA MBYTJA NË ALKOOL E BASHKIMIT SOVJETIK

Ky rrëfim brilant për përpjekjet e gardës së vjetër për të rimarrë kontrollin e mbërthen në mënyrë të shkëlqyer absurditetin e gjithë kësaj ngjarjeje

Nga: John SIMPSON

(The Guardian (titulli: August Coup by Robert Service review the drink-soaked collapse of the Soviet Union))

Sundimi marksist-leninist në Rusi zgjati 74 vjet dhe, në gusht të vitit 1991, praktikisht u shemb brenda vetëm tri ditësh: një dëshmi e qartë se sa bosh ishte bërë. Në periudhën që pasoi, Rusia provoi demokracinë parlamentare dhe kapitalizmin e pastër, pastaj u rikthye në autokraci. Tani ajo po përballet me pasojat e një lufte krejtësisht të panevojshme kundër fqinjit dhe zotërimit të saj të dikurshëm, Ukrainës.

Pse sistemi i Leninit, Stalinit, Hrushovit dhe Brezhnjev it u zhduk kaq shpejt pa luftë? Sepse kështu bien regjimet në Rusi: mjafton të shohësh carizmin në vitin 1917. (Pothuajse ndodhi sërish në qershor 2023, kur njerëzit e komandantit mercenar Jevgenij Prigozhin marshuan drejt Moskës kryesisht pa hasur në ndonjë kundërshtim; Vladimir Putini mund të kishte përfunduar si Nikolla II, po të mos i kishte bërë Prigozhinit disa premtime mjaft të gjera e pastaj, siç pretendohet, ta kishte hedhur në erë dy muaj më vonë.)

Mihail Gorbaçovi erdhi në pushtet në vitin 1985 me synimin për ta shpëtuar BRSS-në. Në vend të kësaj, ai mbikëqyri vdekjen e saj. Ishte një njeri me sharmë, i ndershmë, por jo vizionar, dhe dy ilaçet që i solli pranë shtratit të të sëmurit, Perestrojka (ristrukturimi) dhe Glasnosti (hapja), u treguan krejtësisht të paefektshme. Grushti i shkurtër i shtetit, kundër tij - në gusht të vitit 1991, i udhëhequr nga Vladimir Krjuçkovi, kreu i KGB-së - ishte reagimi instinktiv i një burokracie që e dinte se gjërat po shkonin keq, por nuk kishte absolutisht asnjë ide se çfarë të bënte. Ai dështoi shpejt dhe Gorbaçovi u kthye në tryezën e tij të punës - brenda pak ditësh - por, grushti i shtetit e kishte goditur në mënyrë fatale. Katër muaj më vonë, në fund të vitit 1991, ai u nxor nga pushteti nga muzhiku i fortë, brutal dhe i dhënë pas pijes, Boris Jelcini.

Robert Service, autor i The August Coup [Grushti i shtetit i gushtit], është historiani më i shquar i Rusisë së shekullit XX dhe i bolshevizmit në botën anglishtfolëse. Biografite e tij për tre udhëheqësit kryesorë sovjetikë - Leninin, Stalinin dhe Trockin - janë të jashtëzakonshme edhe në atë fushë kaq të ngjeshur. Duke shkruar për vdekjen e sistemit



që këta njerëz të aftë dhe përbindësua ndihmuar të krijohej, Service ka shfaqur një zotërim të jashtëzakonshëm të burimeve të shumta dhe një stil shkrimi mrekullisht të qartë, që i bën të kuptueshme edhe ndërlikimet e burokracisë sovjetike. Krahasuar me subjektet e tij të mëparshme, historia e grushtit të shtetit kundër Gorbaçovit dhe e shembjes së BRSS-së është relativisht e thjeshtë; megjithatë, Service e udhëheq lexuesin me lehtësi dhe elegancë përmes kaosit të sistemit që po shembej dhe prapaskenave të organizatorëve të grushtit të shtetit.

Pas rënies së Murit të Berlinit në nëntor 1989 dhe humbjes së satrapëve të ndryshëm sovjetikë në Evropën Lindore dhe Qendrore, BRSS-ja po shpërbëhej dhe Gorbaçovi, si president i saj, po humbiste pushtetin dhe ndikimin. Askush nuk e dinte se sa republika sovjetike do të shpëputeshin, ndërsa plani i Gorbaçovit për qeverisjen e asaj që kishte mbetur nga Bashkimi kundërshtojte ashpër. Jelcini ishte president i Republikës Ruse, pjesës më të madhe, më të pasur dhe më funksionale të ish-BRSS-së. Të dy burrat ishin në përplasje të ashpër. Udhëheqësit e grushtit të shtetit nuk mbështesnin asnjërin prej tyre: ata donin t'i riktheheshin një sistemi që do të rivendoste sa më shumë pushtet sovjetik të ishte e mundur. Në atë kohë mendohej se KGB-ja e kishte udhëhequr grushtin e shtetit për të mbrojtur interesat e veta, por Service tregon se Krjuçkovi, kreu

i KGB-së, ishte shumë më i shqetësuar për shembjen e përgjithshme të sistemit sovjetik. Dhe, sidoqoftë, shumë oficerë të KGB-së refuzuan t'i bashkoheshin grushtit të shtetit. Pata fatin të ndodhesha në Moskë gjatë atyre ditëve të jashtëzakonshme. Service e kap në mënyrë të shkëlqyer absurditetin e gjithë kësaj ngjarjeje. Udhëheqësit e grushtit të shtetit e humbën pothuajse menjëherë besimin tek ajo që po bënin, ndërsa shumë prej tyre nuk kishin pasur shumë besim që në fillim. Ata grindeshin, tradhtonin njëri-tjetrin ose mbeteshin të paralizuar nga frika ose plogështia. Shumica e njerëzve të përfshirë lanë ndonjë rrëfim për atë që ndodhi, ndaj burimet që kishte në dispozicion Service ishin veçanërisht të pasura. Ai na jep një përshkrim të gjallë të konferencës fatale për shtyp të cilën organizatorët e grushtit të shtetit dhanë në orën 17:00 të ditës së parë të grushtit të shtetit. Presidenti në detyrë, Genadi Janajev, gjoja ishte në krye, por kishte pirë pandërprerë për një ditë të tërë dhe duart i dridheshin. Konferenca për shtyp u transmetua drejtpërdrejt nga televizioni shtetëror, kështu që të gjithë mund ta shihnin gjendjen në të cilën ndodhej. Pas kësaj, dështimi ishte i pashmangshëm.


Megjithatë, arsyeja themelore e dështimit ishte se organizatorët e grushtit të shtetit nuk arritën ta kapnin Jelcinin. Ishte mjaft e lehtë ta mbyllnin në arrest Gorbaçovin në rezidencën e tij madhështore, Zarja - në bregdetin e Krimesë, ku po

kalonte pushimet me bashkëshorten e tij, Raisën, dhe vajzën e tyre; por, Jelcini mbeti i lirë dhe kishte në dispozicion selinë e Republikës Ruse në Moskë, të njohur si Shtëpia e Bardhë. Dikush do të priste që komplotistët komunistë të ishin të zotët në ndërprerjen e komunikimeve dhe marrjen nën kontroll të mediave, por askush nuk e ndaloj Jelcinin të telefononte aleatët dhe miqtë në mbarë Rusinë dhe në mbarë botën. Po ashtu, askush nuk u përpq ta pengonte të mbante fjalimin e tij të famshëm mbi një tank përpara Shtëpisë së Bardhë, duke dënuar grushtin e shtetit dhe duke u zotuar se do ta mbështeste demokracinë. Ishte një fjalim i mirë dhe pamjet televizive të tij u panë në mbarë botën. Sërisht, askush nuk ua hoqi spinën transmetimeve. Gazetarët si unë mundëm të transmetonim drejtpërdrejt gjatë gjithë grushtit të shtetit. Jelcini qëndroi brenda Shtëpisë së Bardhë, i mbrojtur kryesisht nga një turmë e vogël demonstruesish të paarmatosur, numri i të cilëve u pakësua ndërsa nata e parë kalonte dhe shiu filloi të binte.

Megjithatë, Jelcini vuan nga të njëjtat dobësi si shumë prej organizatorëve të grushtit të shtetit. Në hollin e Shtëpisë së Bardhë iu luta të më lejonin të ngjitesha në zyrën e tij dhe ta intervistojta, por më thanë se ishte tepër i zënë duke biseduar me udhëheqës botërorë dhe duke organizuar kundërshtimin. Më vonë, ish-ministri i Jashtëm sovjetik, Eduard Shevardnadze, mbërriti për ta takuar. Kur doli nga ndërtesa një orë më pas, ai

njoftoi se Jelcini i kishte thënë se do të mbronte lirinë e Rusisë deri në pikën e fundit të gjakut. Fjalë frymëzuese. Tri vjet më vonë, kujtuam së bashku me Shevardnadzen gjithë atë histori. Ai qeshi. "Kur hyra në zyrën e Jelcinin, ai ishte shtrirë pa ndjenja në dyshe, me disa shishe bosh vodke pranë". Po atëherë, ç'ndodhi me luftën deri në pikën e fundit të gjakut? "Si mendon se do të kishte qenë po të kisha dalë dhe t'ju kisha thënë se nuk mund të flisja me Jelcinin sepse ishte bërë tapë"?

I tillë ishte kaosi dhe absurditeti që shoqëruan vdekjen e Bashkimit Sovjetik. Në ditët që pasuan, askush nuk e dinte se ku qëndronte autoriteti. Kameramani i famshëm për guximin dhe shpirtin sipërmarrës, Rory Peck, si dhe unë, hymë në selinë e KGB-së, Lubjanka, dhe xhiruam në vetë zyrën e Krjuçkovit. Pas kësaj, madje xhiruam edhe mesazheve ultrasekrete të KGB-së. Të nesërmen, Rory ofroi të blinte për një milion dollarë përmbajtjen e Muzeut Qendror të Revolucionit. Vetëm fakti që zyrtari përgjegjës nuk mundi të gjente një bankë të gatshme të pranonte aq shumë para në dorë, bëri që marrëveshja të mos realizohej. Ne priremi t'i harrojmë hollësitë e këtij episodi vendimtar. Ndoshta historia e trazuar e Rusisë që nga viti 1991 i ka fshirë ato nga kujtesa jonë. Tani Service ka vënë në shërbim të rrëfimit të mënyrës absurde se si përfundoi Bashkimi Sovjetik, zotërimin e tij madhështor të historisë sovjetike: jo me një shpërthim, por me tingëllimën e shisheve të vodkës. /Telegrafi/



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Dukagjini ndan rrugët me Arsim Thaqin

KLINË, 3 GUSHT - Klubi Futbollistik Dukagjini ka bërë me dije se ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Arsim Thaqin. Nën drejtimin e Thaqit, Dukagjini kishte fituar Kupën e

Kosovës, ku në finale e kishte mposhtur Ferizajin. Falë triumfit në Kupë, Dukagjini ishte paraqitur në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës, por ekipi nga Klina nuk kishte fat në short dhe është

eliminuar nga Lugano e Zvicrës. "KF Dukagjini njofton se, me marrëveshje të dyanshme, është ndërprerë bashkëpunimi me trajnerin Arsim Thaqin, si dhe me ndihmëstrajnerët Valmir Bytyqi, Ahmet Haliti dhe Lekë

Termkolli. Klubi shpreh mirënjohjen dhe falënderimin më të sinqertë për punën, përkushtimin dhe kontributin e dhënë gjatë periudhës së bashkëpunimit", ka njoftuar KF Dukagjini.



LOT DHE EMOCIONE, DAKU I JEP LAMTUMIRËN RUBIN KAZANIT, KALIMI TE SPARTAKU PRANË FINALIZIMIT

KAZAN, 3 GUSHT - Mirlind Daku i ka dhënë lamtumirën Rubin Kazanit në mënyrën më emocionale të mundshme. Klubi rus ka publikuar një video rreth 20-minutëshe, ku janë përmbledhur çastet më të veçanta të sulmuesit shqiptar para, gjatë dhe pas ndeshjes së javës së dytë të kampionatit rus ndaj Akronit e zhvilluar të shtunën. Pamjet përfshijnë golin e Dakut, emocionet pas vërshëllimës përfundimtare, përqafimet me bashkëlojtarët, si dhe fjalimin e mbajtur në dhomat e zhveshjes para skuadrës dhe stafit teknik. Sulmuesi nuk ka arritur t'i fshehë lotët, teksa bashkëlojtarët e ngritën mbi supe pas përfundimit të takimit. Gjithçka lë të kuptohet se kjo ishte paraqitja e fundit e tij me fanellën e Rubin Kazanit. Daku ka realizuar gol në fitoren ndaj Akronit, duke e çuar në dy numrin e golave në po aq ndeshje të këtij edicioni. Në fjalimin e tij para ekipit, ai ka falënderuar të gjithë stafin për

periudhën e kaluar në Kazan. "Faleminderit shumë për këto tri sezone që kemi kaluar së bashku. E di që vij nga një ligë më modeste se kjo e Rosisë dhe do të doja të falënderoja të gjithë futbollistët rusë që na bëjnë ne të huajve të ndihemi si në shtëpi këtu. Nuk di çfarë tjetër të them... Është e vështirë për mua, por është pjesë e jetës dhe është e rëndësishme të ruajmë gjithmonë marrëdhëniet që kemi. Faleminderit shumë!", ka thënë Daku. Sipas raportimeve të medieve ruse, transferimi i tij te Spartaku i Moskës konsiderohet tashmë i mbyllur, me klubin e kryeqytetit që pritet të paguajë rreth 11 milionë euro për kartonin e sulmuesit. Daku i është bashkuar Rubin Kazanit në vitin 2023 dhe gjatë aventurës së tij në elitën ruse realizoi 37 gola në kampionat. Përveç paraqitjeve në nivel klubesh, ai është edhe pjesë e Kombëtares së Shqipërisë. Gjatë qëndrimit në Kazan ai



është shndërruar në lojtarin më të rëndësishëm të skuadrës, ndërsa trajneri Frank Artiga nuk i kurseu vlerësimet për të. "Nuk e di saktësisht se çka do të ndodhë nesër apo gjatë javës, por shenjat janë goxha të qarta. Dhe pavarësisht se çka ndodh, Daku, pos që është lojtar i madh, është person shumë i

dashur në zhveshtore. Ai është lojtar që i jep skuadrës shpirtin e duhur. E ka dërguar Rubinin në një tjetër nivel. Çka do të ndodhë, i dëshirojmë fat", ka thënë Artiga. Edhe ish-trajneri i Rubin Kazanit, Rashid Rakhimov, ka kujtuar mënyrën se si klubi vendosi ta transferonte Dakun,

duke theksuar se kishte besuar në cilësitë e tij që nga fillimi. "Mora përgjegjësinë për transferimin e tij. Thanë se ishte i padobishëm, se askush nuk kishte nevojë për të, edhe pasi gjithçka ishte vendosur. Në fund, e blenë për 1.2 milionë euro. Ne folëm me presidentin e klubit, Marat Safiullin, dhe më në fund arrita ta bindja. Premtova se mund ta shisnim për 4-5 milionë euro. I jam mirënjohës presidentit që na ndihmoi dhe morëm vendimin e duhur", ka thënë Rakhimov për mediumin rus "Sport". Vlerësime të mëdha për Dakun ka dhënë edhe ish-futbollisti i Lokomotivës së Moskës dhe përfaqësueses së Rosisë, Yuri Semin, i cili deklaroi se Spartaku "ka blerë lojtarin më të mirë të kampionatit". Megjithatë nuk kanë munguar opinionet se stili i tij mund të mos i përshtatet Spartakut, gjithçka tregon se Daku është pranë transferimit te një nga klubet më të mëdha dhe më të suksesshme të futbollit rus.

FISNIK ASLLANI SHUMË PRANË TRANSFERIMIT TE RB LEIPZIGU



HOFFENHEIM, 3 GUSHT - Sulmuesi i Kosovës dhe Hoffenheimit, Fisnik Asllani, është shumë pranë transferimit te RB Leipzig, me klubin gjerman që ka bërë hapa vendimtarë për ta mbyllur marrëveshjen. Sipas raportimeve nga Gjermania, Leipzig ka arritur një marrëveshje në parim me lojtarin dhe tani mbeten vetëm disa detaje për t'u zgjidhur para

zyrtarizimit të transferimit. Klubi gjerman është i gatshëm ta aktivizojë klauzolën e liritit prej rreth 30 milionë eurosh, duke lënë shumë pak hapësirë për ndërhyrjen e Barcelonës. Gjiganti katalunas e kishte monitoruar Asllanin prej muajsh dhe e konsideronte alternativë e mundshme në rast se nuk arrinte ta transferonte objektivin kryesor për sulmin.

Megjithatë, Barcelona nuk ka bërë hapa konkretë, ndërsa Leipzig ka vepruar më shpejt dhe tashmë është shumë pranë sigurimit të kartonit të 23-vjeçarit. Asllani e ka zhvilluar një sezon të shkëlqyer me Hoffenheimin, duke tërhequr interesimin e disa klubeve të mëdha evropiane. Vlera e kartonit të tij në faqen e specializuar

"Transfermarkt" është 35 milionë euro, duke e bërë njëherësh lojtarin shqiptar më të shtrenjtë dhe më të vlefshëm. Përveç Barcelonës, edhe Borussia Dortmundi ishte lidhur me emrin e tij, por aktualisht Leipzig është favoriti absolut për ta transferuar sulmuesin e Kosovës. Transferimi mund të zyrtarizohet gjatë kësaj jave.

Nedim Bajrami drejt Arabisë Saudite

GLASGOW, 3 GUSHT - Mesfushori ofensiv Nedim Bajrami pritet ta vazhdojë karrierën në elitën e futbollit të Arabisë Saudite. Bajrami pritet të huazohet nga Rangersi i Skocisë te skuadra saudite Al-Taawoun, në një marrëveshje që do ta mbajë 27-vjeçarin atje deri në përfundim të sezonit 2026/27. Bajrami nuk ishte pjesë e ekipit të Rangersit

në ndeshjen hapëse të sezonit të ri ndaj Dundee Unitedit, pasi te skuadra skoceze nuk llogarisin në shërbimet e tij. Huazimi i Bajramit nga Skocia në Arabinë Saudite pritet të finalizohet dhe zyrtarizohet brenda pak ditësh, pasi pothuajse janë përfunduar të gjitha procedurat. Bajrami është pjesë e Rangersit

që nga viti 2024, kur iu bashkua klubit nga Sassuolo për rreth 4 milionë euro. Megjithatë, sezonin e fundit ai nuk pati hapësirë të madhe, duke luajtur vetëm 519 minuta në të gjitha garat. Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë ka kontratë me skuadrën e Rangersit deri në verën e vitit 2028.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Golden Gloves” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811891995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Golden Gloves” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811891995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Golden Gloves” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811891995 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin dhe seperimin te gurit gëlqeror, ne Bllacë, Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se në datën 09.09.2026 në ora 10:00 Kuvendi Komunal Suharekë., do të organizohet debat publik nga “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651343?pwd=JsyiMjR68gZDwvrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin dhe seperimin te gurit gëlqeror, ne Bllacë, Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar fotovoltai “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60 MW , në Sinajë, Komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2026 në ora 10:00 në objektin në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” komuna Istog, do të organizohet debat publik nga “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMjR68gZDwvrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për vlerësimin e ndikimit në mjedis për parkun solar fotovoltai “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60MW” nga kompania “LOSHI INVEST” L.L.C

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

